



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1813/ 6 prot.

Datë 09/09/2025

V E N D I M

Nr. 1202/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/09/2025, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-49633-05-30-2025, me objekt: “Blerje elektropompa”, me fond limit 9,740,892 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 19.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetles Kanalizime Pogradec Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “NOVAMAT” SHPK me NIPT: K81615002O dhe me adresë: Rruga “Ismail Qemali” Pallati “Samos Toëer”, Kt.8, Nr 41, Njësia Nr.05, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetles Kanalizime Pogradec Sh.A
Adresa: Rr e “Gurasit” Pogradec.
- Persona të interesuar:** Operatori ekonomik “VASAA” SHPK me NIPT: J62903470T dhe me adresë: Lagja “Kryengritja e Fierit” Fier.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e

rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.06.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E hapur*”, me numër reference Nr. REF-49633-05-30-2025, me objekt: “*Blerje elektropompa*”, me fond limit 9,740,892 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 19.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjelles Kanalizime Pogradec Sh.A.

II.2. Në datë 19.06.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 02.07.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Mikael Group” SHPK	0 leke	skualifikuar
2. “VASAA” SHPK	8.209.000 leke	kualifikuar
3. “General Trading” SHPK	8.511.500 leke	skualifikuar
4. “Novamat” SHPK	9.272.205 leke	kualifikuar
5. “Joklen & CO” SHPK	9.523.100 leke	skualifikuar
6. “Collection Products Ag&Li” SHPK	9.728.900 leke	skualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 02.07.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “VASAA” SHPK.

II.5. Në datën 08.07.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5531, datë 08.07.2025, dhe me numër protokoli nr. 1813/2025 prot, datë 09.07.2025 e operatorit ekonomik “Novamat” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1813/1, datë 10.07.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Novamat” SHPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “VASAA” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “VASAA” SHPK nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1813/2 prot., datë 11.07.2024.

II.8. Në datë 15.07.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 389/27 prot, datë 15.07.2025 “Vendim për shqyrtim ankese”, protokolluar me tonën me nr. 1813/3 prot, datë 15.07.2025, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Novamat” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“Pasi u njohëm me ankesën në fjalë, vlerësojmë se:

Ju keni pretenduar se: “Se kualifikimi i OE-së VASAA shpk është bërë në shkelje të specifikimeve teknike sipas përcaktimeve të Dokumentave Standarte të Tenderit (DST), si dhe përcaktimeve të ligjit bazuar në Ligjin Nr. 162 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” i ndryshuar, neni 109 e vijues dhe Vendimi Nr. 285, datë 19.05.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, i ndryshuar, neni 94, neni 97.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori, OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar se subjekti në fjalë është distributor zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

*2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun teknik e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.***

Në rastin konkret, vlerësojmë se OE VASAA sh.p.k. nuk ka përmbushur kriterin e veçantë në lidhje me kapacitetin teknik të produkteve të ofertuar sipas shtojcës 7 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT”. Në këtë formular përcaktohen kriteret e veçanta në rubrikën “Përshkrimi” që duhet të plotësojnë produktet e ofertuara në kuadër të kësaj procedure prokurimi. Sikurse rezulton nga përmbajtja e këtyre përshkrimeve dhe specifikimeve të DST-së, rezulton se produktet (pompat dhe pjesët rezervë) duhet të jenë të prodhuesit KSB (referuar kërimit automatik në Google dhe ChatGPT), për të cilën shoqëria NOVAMAT sh.p.k. është përfaqësues ekskluziv dhe i autorizuar për këtë procedurë, sipas dokumentacionit bashkëngjitur ofertës që ju është paraqitur. Ekskluziviteti i shoqërisë NOVAMAT sh.p.k. për Shqipërinë, i jep të drejtë vetëm kësaj të fundit në lidhje me shitjen e këtyre produkteve në Shqipëri. Në dokumentacionin teknik të tenderit theksohet qartësisht se kërkohen pjesë rezervë për mirëmbajtje dy vjeçare të pompave të instaluar tashmë në vend dhe këto pjesë rezervë këmbimi nuk mund të zëvendësohen me produkte të ndonjë prodhuesi tjetër, pasi përbëjnë pjesë origjinale të sistemit dhe garantojnë funksionimin e sigurt të pajisjeve ekzistuese. Për rrjedhojë operatori ekonomik VASAA sh.p.k. duhet të skualifikohej për mospërmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me specifikimet teknike/kapacitetin teknik, për produktet objekt i prokurimit publik. Gjithashtu, referuar këtij kriterëve të përcaktuar në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit-Kapaciteti Teknik, OE duhet të paraqiste katalogun teknik të prodhuesit sipas përcaktimeve në rubrikën përshkrimi të shtojcës 7 të DST kriterin të cilin ne vlerësojmë se OE VASAA sh.p.k. nuk e ka përmbushur.

2. Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës sqarojmë se: “Operëtori ekonomik i kualifikuar i pari VASSA shpk, ka paraqitur autorizimin e prodhuesit sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit, gjithashtu ka paraqitur katalogun teknik të prodhuesit të mallrave ku vërteton përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Katalogu

ka të detajuar specifikimet teknike të mallrave dhe ato plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike janë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara. Për specifikimet teknike e përcaktuara në shtojcën 7 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKU I LËVRIMI” në mbështetje të nenit 36 pika 2 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në datë 09.06.2025 është ngarkuar në sistem shtojca me ndryshime të specifikimeve teknike ku përcaktohet se çdo tip pompe është shoqëruar me shënimin “**Tipi i përmendur është vetëm për referencë teknike. Ofertuesit mund të ofrojnë çdo pompë ekuivalente që përmbush këto specifikime teknike**”. Pjesët rezervë janë kërkuar për mallrat që do të blihen.

3. Nga verifikimi i dokumentave janë përmbushur kriteret teknike dhe ligjore.

4. Bazuar sa më sipër ankesa juaj nuk gjen mbështetje dhe konsiderohet e pabazuar. 5. Komisioni vendosi mospranimin e ankesës.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Novamat” ShPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “VASAA” SHPK, me pretendimin se: “**ARGUMENTIMI**

Duke vlerësuar se OE VASAA sh.p.k. nuk ka përmbushur kriteret e veçanta të kualifikimit në përputhje me specifikimet teknike të DST, kundërshtojmë kualifikimin e VASAA sh.p.k. në këtë procedurë prokurimi. Konkretisht në Dokumentet Standarte të Tenderit - Kriteret e Veçanta të Kualifikimit - Kapaciteti Teknik në pikën 2.3.4 dhe 2.3.5, përcaktohet:

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori, OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar se subjekti në fjalë është distributor zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

*2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun teknik e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.***

Në rastin konkret, vlerësojmë se OE VASAA sh.p.k. nuk ka përmbushur kriterin e veçantë në lidhje me kapacitetin teknik të produkteve të ofertuar sipas shtojcës 7 “FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT”.

Në këtë formular përcaktohen kriteret e veçanta në rubrikën “Përshkrimi” që duhet të plotësojnë produktet e ofertuara në kuadër të kësaj procedure prokurimi.

Sikurse rezulton nga përmbajtja e këtyre përshkrimeve dhe specifikimeve të DST-së, rezulton se produktet (pompave dhe pjesët rezervë) duhet të jenë të prodhuesit KSB (referuar kërkit automatik në Google dhe ChatGPT), për të cilën shoqëria NOVAMAT sh.p.k. është përfaqësues ekskluziv dhe i autorizuar për këtë procedurë, sipas dokumentacionit bashkëngjitur ofertës që ju është paraqitur.

Ekskluziviteti i shoqërisë NOVAMAT sh.p.k. për Shqipërinë, i jep të drejtë vetëm kësaj të fundit në lidhje me shitjen e këtyre produkteve në Shqipëri.

Në dokumentacionin teknik të tenderit theksohet qartësisht se kërkohej pjesë rezervë për mirëmbajtje dy vjeçare të pompave të instaluar tashmë në vend dhe këto pjesë rezervë këmbimi nuk mund të zëvendësohen me produkte të ndonjë prodhuesi tjetër, pasi përbëjnë pjesë origjinale të sistemit dhe garantojnë funksionimin e sigurt të pajisjeve ekzistuese.

Për rrjedhojë operatori ekonomik VASAA sh.p.k. duhet të skualifikohej për mospërmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit në lidhje me specifikimet teknike/kapacitetin teknik, për produktet objekt i prokurimit publik.

Gjithashtu, referuar këtij kriterëve të përcaktuar në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit-Kapaciteti Teknik, OE duhet të paraqiste katalogun teknik të prodhuesit sipas përcaktimeve në rubrikën përshkrimi të shtojcës 7 të DST kriterin të cilin ne vlerësojmë se OE VASAA sh.p.k. nuk e ka përmbushur.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” pika 2.3.4 dhe pika 2.3.5 “*Kapaciteti teknik*” të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*”, të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret e veçanta kualifikuese, si më poshtë vijon:

“2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori, OE duhet të paraqesë dokumentacionin për të vërtetuar se subjekti në fjalë është distributor zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plotë të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun teknik e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.**”.

III.1.2. Në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike që duhet të plotësojnë produktet objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

- ❖ *Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

❖ **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Karakteristikat konstruktive të grupit të pompave

E/Pompat zhytëse - Të përshtatshme për instalim në nje rezervuar për akumulimin e ujit. Pompë dhe motor që përmbushin standartet shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë si: SSH EN ISO 12100; SSH EN 809; SSH EN 60034, SSH EN ISO 3744.

Kurba e performancës së pompës të paraqitet sipas standarteve ISO të kërkuara.

Pompat të punojnë pa shfaqur avari edhe në rastet kur ka përmbajtje rëre deri në 100g/m³. Klasa e mbrojtjes të motorrit të jetë të paktën IP68.

- *Karakteristikat e materialeve të përdorura për prodhimin e pompave:*

<i>Filtri i thithjes:</i>	<i>Inoks AISI 304</i>
<i>Kafazi i thithjes:</i>	<i>Gizë</i>
<i>Helika:</i>	<i>Inoks AISI 304</i>
<i>Difuzori:</i>	<i>Inoks AISI 304</i>
<i>Bokulla e kushinetës</i>	<i>Gome nitrile</i>
<i>Boshti i pompës</i>	<i>Inoks AISI 304</i>
<i>Trupi i kundravalvulës</i>	<i>Gizë</i>
<i>Tapa e valvulës</i>	<i>Inoks AISI 304</i>
<i>Mbështetësja e valvulës</i>	<i>Teflon ose ekuivalent me përmbajtje karboni</i>
<i>Fllanxa lidhëse</i>	<i>Çelik</i>
<i>Mbrojtësja e kabllit</i>	<i>Inoks AISI 304</i>
<i>Gominat izoluese</i>	
<i>Gomë Nitrile Vidat dhe pjesët e tjera të pompës</i>	<i>Inoks AISI 304</i>
<i>Motorr elektrik zhytës me fllanxa, 50Hz, a-sinkron, trefazor i lubrifikuar me ujë.</i>	

- *Karakteristikat e materialeve të përdorura për prodhimin e motorrëve*

<i>Rrotori</i>	<i>Inoks</i>
<i>Supportet</i>	<i>Gizë</i>
<i>Trupi i motorrit</i>	<i>Gizë</i>
<i>Gomina e kabllit</i>	<i>Gomë nitrile</i>

Gomina e suportit me trupin	Gomë nitrile
Mbrojtje e pështjellave	Poliacetal
Baza e motorrit	Gizë
Diafragma	Gomë nitrile
Mbulesa e diafragmës	Inoks
Kushineta	Inoks me grafit
Balancuesit	Inoks

- Karakteristikat e kabllit të pompave:

Kablli duhet të jetë fleksibël me rezistencë të lartë ndaj tërheqjes, min 15N/mm². Të jetë i testuar në tension 2000V dhe temperaturë deri në 200°C.

II-Specifike të vecanta

Karakteristikat minimale të veçanta të pompave centrifugale horizontale

Specifikim Teknik: Pompë Centrifugale për Ujë të Pijshëm

1. Përshkrimi i përgjithshëm:

Furnizimi, instalimi dhe vënia në punë e një pompe centrifugale për ujë të pijshëm, e përshtatshme për funksionim të vazhdueshëm dhe presione të mesme-të larta, për përdorim në impiant furnizimi me ujë ose stacion pompimi.

2. Të dhëna teknike të kërkuara:

I. Stacioni i Pompimit të ujit të pijshëm Guras

Parametri	Vlera minimale e kërkuar
Kapaciteti hidraulik (Q)	83.32 m ³ /h (≈ 23.15 l/s)
Lartësia manometrike (H)	≥ 63.71 m
Presioni maksimal i punës	≥ 8 bar
Efikasiteti hidraulik	≥ 70% në pikën e projektimit
Fuqia e motorit	≥ 18 kW (400 V / 3 faza / 50 Hz)
Klasa e motorit	IE3 ose më e lartë
Mbrojtja e motorit	IP55
Klasa e izolimit	F
Temperatura e lëngut	0 – 40 °C
NPSH kërkuar	≤ 3.5 m

3. Materialet e ndërtimit (të gjitha pjesët në kontakt me ujin):

Trupi i pompës: Gize e veshur me epoksi ose çelik inox AISI 304

Helika: Inox AISI 304/316 ose bronz marin

Boshti: Inoks AISI 316

Vulat mekanike: Qeramikë/grafit, të përshtatshme për ujë të pijshëm

Vidhat/fiksuesit: Inoks

4. Certifikime të kërkuara:

Pompë e certifikuar për përdorim me ujë të pijshëm në përputhje me:

WRAS (UK), ose ekuivalente DVGW (Gjermani), ose ekuivalente ACS (Francë), ose ekuivalente ose NSF/ANSI 61 (SHBA) ose ekuivalente

Prodhimi në përputhje me:

EN ISO 5199, ISO 9906 Class 2, EN 733 (ose ekuivalente)

Direktiva PED 2014/68/EU dhe 2006/42/EC (makineritë)

II. Stacioni i Pompimit të ujit të pijshëm Geshtenjas

Specifikim Teknik për Tender: Pompë Centrifugale Horizontale me Shumë Shkallë

1. Përshkrimi i përgjithshëm:

Furnizimi, instalimi dhe vënia në punë e një pompe centrifugale horizontale me shumë shkallë për ujë të pijshëm, e kompletuar me motor elektrik dhe e përshtatshme për punë të vazhdueshme në sisteme me presion të lartë të shpërndarjes së ujit.

2. Të dhëna teknike të kërkuara:

Parametri	Vlera minimale e kërkuar
Kapaciteti hidraulik (Q)	68 m ³ /h ($\approx$ 18.89 l/s)
Lartësia manometrike (H)	≥ 153.5 m
Presioni maksimal i punës	≥ 16 bar
Efikasiteti hidraulik	$\geq 70\%$ në pikën e projektimit
Fuqia e motorit	≥ 30 kW (400 V / 3 faza / 50 Hz)
Klasa e motorit	IE3 ose më e lartë
Mbrojtja e motorit	IP55
Klasa e izolimit	F
Temperatura e lëngut	0 – 40 °C
NPSH kërkuar	≤ 3.5 m

3. Materialet e ndërtimit (të gjitha pjesët në kontakt me ujin):

Trupi i pompës:

Çelik inox AISI 304 ose gize e veshur me epoksi

<i>Helikat:</i>	<i>Inox AISI 304/316</i>
<i>Disqet ndarës dhe difuzorët:</i>	<i>Inox ose plastikë teknike e certifikuar</i>
<i>Boshti:</i>	<i>Inoks AISI 316</i>
<i>Vulat mekanike:</i>	<i>Qeramikë/grafit, të përshtatshme për ujë të pijshëm</i>
<i>Vidhat/fiksuesit:</i>	<i>Inoks</i>

4. Certifikime të kërkuara:

Pompë e certifikuar për përdorim me ujë të pijshëm në përputhje me:

WRAS (UK), ose ekuivalente DVGW (Gjermani), ose ekuivalente ACS (Francë), ose ekuivalente ose NSF/ANSI 61 (SHBA) ose ekuivalente

Prodhimi në përputhje me:

EN ISO 5199, ISO 9906 Class 2, EN 733

Direktiva PED 2014/68/EU dhe 2006/42/EC (makineritë)

Specifikim Teknik: Pompë Centrifugale për Ujëra të Përdorura

1. Përshkrimi i përgjithshëm:

Furnizimi, instalimi dhe vënia në punë e një pompe centrifugale horizontale për ujëra të përdorura (ujëra të zeza ose të ndotura), me kapacitet të lartë rrjedhje dhe lartësi të ulët manometrike, e përshtatshme për stacione pompimi në sisteme kanalizimi apo impiante për trajtimin e ujërave.

2. Të dhëna teknike të kërkuara:

I. Stacioni i Pompimit të ujerave të përdorura 1 Maj

<i>Parametri</i>	<i>Vlera minimale e kërkuar</i>
<i>Kapaciteti hidraulik (Q)</i>	<i>151 l/s ($\approx 543.6 \text{ m}^3/\text{h}$)</i>
<i>Lartësia manometrike (H)</i>	<i>$\geq 19.8 \text{ m}$</i>
<i>Presioni maksimal i punës</i>	<i>$\geq 6 \text{ bar}$</i>
<i>Fuqia e motorit</i>	<i>$\geq 45 \text{ kW}$ (400 V / 3 faza / 50 Hz)</i>
<i>Klasa e motorit</i>	<i>IE3 ose më e lartë</i>
<i>Mbrojtja e motorit</i>	<i>IP68 (nëse është nënujore), IP55 (nëse mbi tokë)</i>
<i>Klasa e izolimit</i>	<i>F</i>
<i>Temperatura e lëngut</i>	<i>0 – 40 °C</i>
<i>Diametri maksimal i grimcave</i>	<i>$\geq 80 \text{ mm}$</i>

3. Materialet e ndërtimit (të gjitha pjesët në kontakt me ujin):

<i>Trupi i pompës:</i>	<i>Gize EN-GJL-250 ose çelik inox</i>
<i>Helika:</i>	<i>Gize sferoidale ose helikë vetëpastruese prej inoxi</i>
<i>Boshti:</i>	<i>Inoks AISI 420 ose 316</i>
<i>Vulat mekanike:</i>	<i>Qeramikë/grafit të përshtatshme për ujëra të ndotura</i>
<i>Rrethimet statike:</i>	<i>EPDM ose NBR</i>
<i>Vida/fiksues:</i>	<i>Inoks</i>

4. Certifikime të kërkuara:

Pompë e projektuar për transportin e ujërave të ndotura sipas standardeve ndërkombëtare të mëposhtme:

ISO 9906 (Class 2) ose ekuivalente

EN 12050 për pajisje për ujëra të ndotura

Direktiva PED 2014/68/EU dhe 2006/42/EC (makineritë)

1.Stacioni i Pompimit te ujerave te perdorura Pogradec2 Tushemisht

<i>Parametri</i>	<i>Vlera minimale e kërkuar</i>
<i>Kapaciteti hidraulik (Q)</i>	<i>36 m³/h (10 l/s)</i>
<i>Lartësia manometrike (H)</i>	<i>≥ 22.5 m</i>
<i>Presioni maksimal i punës</i>	<i>≥ 5 bar</i>
<i>Tipi</i>	<i>Nenujore (submersible)</i>
<i>Fuqia e motorit</i>	<i>≥ 5.5kW (400 V / 3 faza / 50 Hz)</i>
<i>Klasa e motorit</i>	<i>IE3 ose më e lartë</i>
<i>Mbrojtja e motorit</i>	<i>IP68</i>
<i>Klasa e izolimit</i>	<i>F</i>
<i>Temperatura e lëngut</i>	<i>0 – 40 °C</i>
<i>Diametri maksimal i grimcave</i>	<i>≥ 65 mm</i>

3. Materialet e ndërtimit (të gjitha pjesët në kontakt me ujin):

<i>Trupi i pompës:</i>	<i>Gize EN-GJL-250 me mbrojtje epoksi</i>
<i>Helika:</i>	<i>Gize sferoidale ose helikë (me dizajn antibllokues)</i>
<i>Boshti:</i>	<i>Inoks AISI 420 ose 316</i>
<i>Vulat mekanike:</i>	<i>Qeramikë/grafit me vajosje te dyfishte</i>
<i>Rrethimet statike:</i>	<i>EPDM ose NBR</i>
<i>Vida/fiksues:</i>	<i>Inoks A2 ose me i larte</i>

4. Certifikime të kërkuara:

Pompë e projektuar për transportin e ujërave të ndotura sipas standardeve ndërkombëtare të mëposhtme:

*ISO 9001, ISO 9906 (Class 2) ose ekuivalente
EN 12050 për pajisje për ujëra të ndotura
Direktiva 2014/30/EMC 2014/35 /EU dhe 2006/42/EC (makineritë)*

Akseseore dhe opsione :

*Bazament i salduar me amortizues vibrimi
Sensor presioni dhe valvola nje drejtimeshe
By – pass ose inverter per kontroll presioni
Manual teknik ne gjuhen shqipe dhe anglisht*

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkthuhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent". Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*
 - b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*
 - c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*
- Skicimet, parametrat teknik etj:*

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

III.1.3. Në shtojcën 7 “**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar sasinë dhe grafikun e lëvrimit të produkteve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

E/POMPA PER STACIONE TE SHOQERISE UJESJELLES_KANALIZIME					
Nr.	Vendndodhja	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Pershkrimi
	WATER SUPPLY PUMPING STATIONS(E/Pompa per ST/Pompimi Uji i pijshem)				
1	PS:Guras	Pompe e kompletuar me motor ETN 065-050-200 GG AA11GD20220 Tipi: SN: 9973059885 000200 01 Mesme:Per uje te pijshem $Q=83.32 \text{ m}^3/\text{h}$ $H=63.71\text{m}$ 2958 rpm	cope	1	Tipi 065-050-200 GP ETN 065-050-200-GPKAA11GSEEV Pompe centrifugale me presion te ulet sipas EN 733,miraturar per uje te pijshem Pompe+Bashkim+Roje bashkuese+Bazament+Motor <u>Shenim: Tipi i permendur eshte vetem per reference teknike. Ofertuesi mund te ofroje cdo pompe ekuivalente qe permbush keto specifikime teknike</u>
1.1		Pjeset me te konsumueshme per mirembajtje 2 vjecare	SET	1	
1.1.1			SET	1	Gasket 20/24X0.3 DPAF 2pcs

1.1.2			SET	1	KIT-MECH SEAL ETN-WS25-11 Permbajtja/ 1 PC: 1 PC 433 MECHANICAL SEAL(vule mekanike) 1 PC 400.10 GASKET(Litare) 1 PC 400.10 GASKET 1 PC 400.10 GASKET 1 PC 523 SHAFT SLEEVE (Menge bosht) 1 PC 400.75 GASKET
1.1.3			SET	1	KIT-SHAFT SLEEVE A 20,4/28X 50(Menge Boshti) Permbajtja/ 1 PC: 1 PC 523 SHAFT SLEEVE 1 PC 400.75 GASKET (litare)
1.2		Set of bearings for pump and motor (Komplet kushinetash per pompen e motorin)	SET	1	Grooved ball bearing 6305-2 Z C3 2pcs DIN625 steel(Kabinet kushinete me brazde celiku)
1.2.1			SET	1	Motor ball bearing kit 1pcs(Kompleti i kushinetave te motorit) Motor ball bearing kit(Kompleti i kushinetave te motorit)
2	PS:Geshthenjas	Horizontal multistage centrifugal pump completed with motor(Pompe centrifugale Horizontale me shume shkalle e kompletuar me motor) Model:Multitec Tipi: Multitec B 65/ 3C-6.1 12.67 ose ekuivalente Mesme:Per uje te pijshem	cope	1	Ring-section pump (Pompe me seksion unaze) Multitec B 65/3C-6.1 12.67 ose ekuivalente IE3 fulfills ErP 2015. <u>Shenim: Tipi i permendur eshte vetem per reference teknike. Ofertuesi mund te ofroje cdo pompe ekuivalente qe permbush keto specifikime teknike</u>

		<i>Viti : 2017</i>			
		<i>No: 9973416761 / 000100 / 02</i>			
		<i>Q=68 m³/h</i>			
		<i>H=153.5m</i>			
		<i>P=45 kW</i>			
		<i>2966 rpm</i>			
2.1		<i>Pjeset me te konsumueshme per mirembajtje 2 vjecare</i>	<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>Spare parts for Multitec B 65/3C-6.1 12.67(ose ekuivalente Pjese kembimi) KIT-GASKET BOUCHONS 42-95 Permbajtja/ 1 PC: Saia Partno. Pershkrimi 5 PC 411.23 JOINT RING (Unaze e Ngjitshme) 10 PC 411.1 JOINT RING 10 PC 411.2 JOINT RING 5 PC 411.4 JOINT RING 10 PC 411.8 JOINT RING 1 PC 411.18 JOINT RING</i>
2.1.1			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>SET OF GASKETS MTC 65 (412.1)(Set litaresh)</i>
2.1.2			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>KIT-GASKET MTC 65 Permbajtja/ 1 PC: 2 PC 411.1 JOINT RING 2 PC 412.2 O-RING 1 PC 412.3 O-RING 2 PC 412.4 O-RING 2 PC 412.5 O-RING 2 PC 412.10 O-RING 2 PC 507 THROWER 1 PC 411.7 JOINT RING</i>
2.1.3			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>MEC SEAL-BURGMANN KB040S-H7N(Vula mekanike)</i>
2.1.4			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>shaft sleeve 35/45X111 1.4057+QT800 (Menge</i>

					boshti) Code 42+45+55+62+63+67+81 MTC 65
2.1.5			SET	1	SET OF ANTI-FRICTION MTC 65 / A-B(set Kunderferkimi) 2 x 320.1 ANGULAR CONTACT BEAR 7309B UA 1 x 520.1 SLEEVE 35/ 45 X 55 1 x 412.10 O-RING 34,52X 3,53-N-B-220 3 x 551.1 SHIM RING 80X100X0,2(unaze me spesor) 1 x 551.1 SHIM RING 80X100X1
2.2		Set of bearings for pump and motor(Komplet kushinetash per pompen e motorin)	SET	1	Motor ball bearing kit(Kompleti i kushinetave te motorit) Motor ball bearing set for VFD driven motor
WASTE WATER PUMPING STATIONS(E/Pompa per ST/Pompimi Ujera Te perdorura)					
3	PS: 1 Maj	Volute casing pump completed with motor(Pompe e mbeshjelljes se volumit me motor) Model: Tipi: F 200 400G 3HM 2805 ose ekuivalente SN: 317515 Viti: 2014 No. 9972088527000500 Mesme: Per ujera te	cope	1	Volute casing pump in back pull-out design(Me terheqje mbrapa) E 200-401G 3HM 280S 04 IE4 fulfills ErP 2017+. Single speed motor suitable for VFD operation(motor me shpejtesi te pershtatshme per funksionim VFD) Variant: Hydraulic performance Not documented belt drive This variant is indispensable for the application. (Ky variant

		<i>perdorura</i> <i>Q=151 l/s (543.6 m3/h)</i> <i>H=19.8m</i> <i>2094 rpm</i>			<i>eshte i domosdoshem per aplikim)</i> <u>Shenim: Tipi i permendur eshte vetem per reference teknike. Ofertuesi mund te ofroje cdo pompe ekuivalente qe permbush keto specifikime teknike</u>
3.1		<i>Pjeset me te konsumueshme per mirembajtje 2 vjecare</i>	<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>Spare part for pump E 200-401G 3HM 280S 04 O-RING 345 X 5 N Material: NBR 80</i>
3.1.1			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>O-RING 82,22X 2,62-N-B-152 Size/Dimension: 82,22X 2,62-N-B-152 BasicMat: FKM 80</i>
3.1.2			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>O-RING 78,97X 3,53-N-B-235 Size/Dimension: 78,97X 3,53-N-B-235 BasicMat: NBR 80</i>
3.1.3			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>O-RING 355,00X 4,00-N-B Size/Dimension: 355,00X 4,00-N-B BasicMat: NBR 80</i>
3.1.4			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>O-RING 230,00X 5,00-N-B Size/Dimension: 230,00X 5,00-N-B BasicMat: NBR 80</i>
3.1.5			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>O-RING 405,26X 5,33-N-B-385 Size/Dimension: 405,26X 5,33-N-B-385 BasicMat: NBR 70</i>
3.1.6			<i>SET</i>	<i>1</i>	<i>ROT SHAFT LIP SEAL AS 80X100X10 Size/Dimension:AS 80X100X10 BasicMat: NBR</i>

3.1.7			SET	1	MECH SEAL-BURGMANN EMG1 /075S-G6 Size/Dimension: EMG1 /075S-G6 BasicMat: Q7Q7VGG-Y10
3.1.8			SET	1	MECH SEAL-BURGMANN EMG1 /075S-G6 Size/Dimension: EMG1 /075S-G6 BasicMat: AQ7PGG-Y10
3.2		Set of bearings for pump and motor (Komplet kushinetash per pompen e motorin)	SET	1	CYL ROLLER BEARING NU 416 Size/Dimension: NU 416 BasicMat: ST
3.2.1			SET	1	ANGULAR CNTCT BEAR 7319B UA Size/Dimension: 7319B UA BasicMat: ST
3.2.2			SET	1	Motor ball bearing kit (Kompleti i kushinetave te motorit) Motor ball bearing kit for VFD operation
4	PS: Pogradec 2	Submersible waste water pump completes with motor (Pompe zhytese e ujerave te perdorura me motor) Model: Tipi: KRT F 80-250/ 74 YG- S ose ekuivalente No. 9971286656/800 Q=36 m3/h H=22.5m P2=5.5 Kw 400/690V 50 Hz 1455 rpm	cope	1	Submersible Motor Pump(Pompe zhytese me motor) KRTF 80-252/154YEG-S IE3 ose ekuivalente Scope of supply as per data sheet(Fushe veprimi i furnizimit) <u>Shenim: Tipi i permendur eshte vetem per reference teknike. Ofertuesi mund te ofroje cdo pompe ekuivalente qe permbush keto specifikime teknike</u>

		IP68			
		ATEX: EX II 2G Eex d IIB			
		Insulation class F(Klasa e izolimit F)			
4.1		Pjeset me te konsumueshme per mirembajtje 2 vjecare	SET	1	Spare parts for KRTF 80-252/154YEG-S IE3 SET OF GASKETS 1 X 52MM(Pjese kembimi set litaresh)
4.1.1			SET	1	SET OF GASKETS KA13/16 E250 6308
4.1.2			SET	1	PROFILDICHTUNG DN 80 PROFILE JOINT Material: NBR 60
4.1.3			SET	1	KIT-MECH SEAL 22/25-NBR-MG1 Permbajtja/ 1 PC: 1 PC433.01 MECHANICAL SEAL 1 PC 433.02 MECHANICAL SEAL 1 PC 515 TAPER LOCK RING(Unaze me kycje konike)
4.2		Set of bearings for pump and motor(Komplet kushinetash per pompen	SET	1	RADIAL ROLL BEARING 206 ECP C3
4.2.1		e motorin)	SET	1	DEEP GROOVE BALL BEARING(Kushinete me brazde te thelle) Material: ST

- **Afatet e lëvrim:** Afati i lëvrim të mallit do të jetë: maximum 8-10 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 3, “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”.

III.1.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të modifikuara sikurse përmendëm më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor në Shtojcën 7 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të këtyre dokumentave ka përcaktuar llojin, sasinë dhe grafikun e lëvrimit të produkteve objekt prokurimi, ndërsa në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të po këtyre diokumentave autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimi.

Gjithashtu nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit sikurse përmendëm edhe më sipër dhe konkretisht i kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT*” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatorët ekonomik ofertues për për produktet objekt prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 7 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumentave të tenderit duhet të paraqesin autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për produktet e ofruara, ndërsa në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.5 të pikës 2 “*KRITERET E VEÇANTA TË*

KUALIFIKIMIT” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që operatori ekonomik ofertues për produktet e ofruara duhet të paraqesë katalogun teknik të prodhuesit të produkteve të ofruara, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse specifikimet teknike të produkteve të ofruara i plotësojnë specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të po këtyre dokumentave.

Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk është kërkuar në asnjë rast që ofertuesit të paraqesin katalogun teknik të prodhuesit të produkteve të ofruara, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të produkteve të ofruara me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse specifikimet teknike të produkteve të ofruara i plotësojnë specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimi të përcaktuara në Shtojcën 7 “*FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT*” të dokumentave të tendertit, pasi specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimi janë përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në Shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tendertit, kërkesë e cila do të përbënte detyrim për t’u përmbushur nga ofertuesit.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cenon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Për sa më lart, pretendimi operatorit ekonomik “*Novamat*” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*VASAA*” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Novamat” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me numër reference Nr. REF-49633-05-30-2025, me objekt: “Blerje elektropompa”, me fond limit 9,740,892 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 19.06.2025, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjes Kanalizime Pogradec Sh.A.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Novamat” SHPK
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

